REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2887/2 prot., Datë 29.12.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Orto – Implant" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur*", me Nr. REF-51244-11-24-2022, me objekt: *"Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike" per Spitalin Rajonal Durres, Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 2 vjecar",* me fond limit 16.666.460 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 12.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues: "Orto – Implant" SHPK
Autostrada TR – DR, Km.10, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Durrës
Lagja Nr.8, Rruga "A.Goga", Durrës

Në datën 29.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. protokolli 2887/2022 datë 29.12.2022 e operatorit ekonomik "Orto – Implant" SHPK për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur*", me Nr. REF-51244-11-24-2022, me objekt: *"Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike" per Spitalin Rajonal Durres, Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 2 vjecar",* me fond limit 16.666.460 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 12.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Orto – Implant" SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma "b" të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", ku parashikohet se: "*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;".

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik "Orto – Implant" SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokolli 2887/2022 datë 29.12.2022. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

1.OE "Orto Implant" Shpk me NIPT M02417015A nuk ka plotesuar Kriterin 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar germa c ku kerkohet qe OE te paraqese kopje te certifikuara/vertetuara te bilanceve per tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021) qe tregojne raportet ndermjet aktivit dhe pasivit. OE ka paraqitur vetem pasqyrat financiare te vitit 2021, nderkohe qe kerkohen paqyrat financiare te tre viteteve te fundit 2019,2020,2021 te cilat sduhet te kene raport negativ ndermjet aktivit dhe pasivit.

2. OE nuk ka plotesuar nenpiken e Kapacitetit Teknik "Deklarate qe do te vere ne dispozicion qe do te kryhet setet e montimit (minimumi nje set montimi) dhe te pakten nje infermier (instrumentar)te trajnuar per perdorimin e seteve". OE nukka ngarkuar ne SPE certifikaten nga kompania prodhuese Zimmer Biomet qe te provoje trajtimet per setet e prodhuara nga kjo kompani,por ka bashkalidhur certifikate trajnimi vetem per setet e prodhuara nga kompania prodhuese TST.

3. Disa nga mostrat e paraqitura sipas procesverbalit te mostrave Nr.1960/13 prot,date 20.12.2022 nuk jane ne perputhje me specifikimet e vendosura nga A.K sipas DST.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 29.12.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2022.12.29 16:47:32 +02'00'